

Data \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

**PROCESVERBAL ARGUMENTIMI**  
**Tipi i kontratës - Pune**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objkti i Procedures:** “Pershtatje e ambienteve te OSHEE GROUP sh.a per nevojat e personelit”.

Kodi Perkates ne fjalorin e perbashket te Prokurimit (CPV): 45453000-7– Riparime dhe Renovime

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 4,075,485 (Kater milion e shtatedhete e pese mije e katerqind e tetdhete e pese) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ne piken 1 te nenit 6 te ligjit 16/2024, “per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit eshte nen kufirin e ulet monetar. Ne perputhje me nenin 33 te LPP kufijte monetare jane:

a) Kufiri i lartë monetar:

- 650.000.000 (gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 40.000.000 (dyqind milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

b) Kufiri i ulët monetar:

- 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

Per sa mesiper, referuar Nenit 49 te LPP ku shprehet qe Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e hapur të thjeshtuar për kontrata nën kufirin e ulët monetar, per sa mesiper AK ka vendosur qe Procedura te jete e hapur e thjeshtuar – Pune.

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsytimit te meposhtem:**

Kemi te bejme me punen e furnizimit dhe vendosje materialesh te te njejtit grup, ne menyre qe dhe garancia te jete e mbuluar plotesisht, mos te kete hapsire midis furnizimit dhe vendosjes ky objekt duhet te kryhen nga nje operator i vetem, ndaj kjo procedure nuk mund te ndahet ne lote.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

Kërkesat e mësipërme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet tatimore dhe ato të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertës është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi mësipërcituar, si një mjet garancie për AK në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 800,000 (Teteqind mije) leke pa TVSH.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 49 dhe nenin 77 pika 3, e LPP, në nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të dhe nenin 55 pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Duke marrë në konsideratë rëndesinë, fondin limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e furnizimit dhe të vendosjes si dhe cilësinë që kërkohet, OE ofertues duhet të vertetojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo më pak vitet e fundit financiare të jete në masën 800,000 (Teteqind mije) leke pa TVSH, duke qendruar madje brenda normës prej 40 % të vlerës së fondit limit që prokurohet, norme që përcaktohet si limit i mundshëm nga LPP 162/2020 dhe në nenin 55 pika 4 e VKM 285/2021 e ndryshuar.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nëni 13 pika 2: “*Tatimpaguesit*

*e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, .....*”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros është Brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohet. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë ne treg si dhe per rritur numrin e konkurrentëve në kete procedure eshte gjykuar qe vlera e xhiros se kerkuar te jete jo me teper se 40 % e vleres se parashikuar te kontrates.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se:” Autoriteti / enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Ndër të tjera, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u mbështetur gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përkatesisht në miratimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. “

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per:**

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 1,000,000 leke dhe që është që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 4,000,000 leke pa TVSH.

- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- *Për përvoja te mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe punet e realizuara.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe punet e realizuara.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punet të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomikë që ofrojnë këto lloje furnizim vendosjesh, pavarësisht rëndësisë dhe kompleksitetit të objektit të procedurës të prokurimit, bazuar dhe në frymën e konkurrencës që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë nën 30 % e vlerës së parashikuar (në vijimesi edhe me LLP) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK, autoritetet kontraktore mban në konsideratë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontratës, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**N.P – 2 A** Ndertime civile e industriale.

**N.S – 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendet origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari

ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, 5renda5 ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 ku përcaktohet se: çdo 5renda5 juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licencave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

#### **N.P – 2 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash.**

Me punime të tilla, referuar VKM Nr.42 të 5rend 16.01.2008 konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, 5renda5, godina 5renda5uto, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderrur, betonim të tavaneve të hollë, 5renda5u, kupola, depozita të varura, 5rend dhe ndërtime të larta me 5renda5ut me karakteristika të veçanta e komplekse.

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Ndërhyrjet objekt kontrate, parashikojnë prishje dhe ndertim murr gipsi, vetrata, etj. Në total vlerat për realizimin e ndërtimit të ri dhe kompletimin me strukturat e nevojshme te punime plotësuese dhe pajisje i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë A sipas VKM Nr.42 të 5rend 16.01.2008, të ndryshuar.

#### **N.S – 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.**

Me punime të tilla, referuar VKM Nr.42 të dates 16.01.2008 Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe

ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dysHEMEVE të tipeve të ndryshme dhe me brenda6u të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material brenda6 dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me brenda6u të ndryshme.

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Ndërhyrjet objekt kontrate, parashikojnë prishje dhe ndertim murr gipsi, vetrata, etj. Në total vlerat për realizimin e ndërtimit të brenda kompletimin me strukturat e nevojshme të punime plotësuese dhe pajisje i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë A sipas VKM Nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar.

**2.3.3.** Operatori ekonomik ofertues për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt të vertetuar me kontrate noteriale pune të vlefshme, diplomën perkatese dhe të figurojë në listëpagesën e subjektit si drejtues teknik, të pakten për muajin e fundit nga data e hapjes, si mëposhte:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi; (kontrate pune noteriale, CV, liçencë).

**Argumentim:** Autoriteti Kontraktor këte kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit brenda”, Kreu V, Seksioni III, Neni 36, pika 5/b.

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Këtu nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e objektit të prokurimit, si dhe kërkesat për fuqi punëtore referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi. Në kërkesat për personelin e kualifikuar nga AK është kërkuar një kategori personeli, i domosdoshëm për të kryer të gjitha shërbimet e nevojshme dhe mbulimin e të gjitha hallkave/etapave të realizimit të projektit, sipas nivelit të kompetencave profesionale deri në realizimin e plotë të kontrates.

Lloji i profesionit të inxhinierit të kërkuar lidhet me natyrën e furnizimit vendosjes sipas zerave të preventivit. Inxhinieri i ndërtimit kërkohet për të ndjekur të gjitha proceset e ndërtimit e të prishjes si dhe problematikave të tjera që mund të dalin gjatë rruges.

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**2.3.4.** Operatori ekonomik ofertues për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojë në listëpagesën e subjektit, të pakten për muajin e fundit nga data e hapjes të pakten 8 punonjës ku të kualifikuar të jenë punëtorët si mëposhte:

1 (nje) Punonjës specialist ndërtimi me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të akredituara.

2 (dy) Punonjës teknikë D/Alumini plastik me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të akredituara.

2 (dy) Punonjës Muratore & Suvatues me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të akredituara

1 (një) Punonjës bojxhi me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të akredituara.

1 (një) Punonjës gipsi me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të akredituara.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës në formatin e përcaktuar nga ligji e vlefshme dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik nga institucione të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente.

**Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të pare, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.**

**Argumentimi:** Në kriterin mesipercituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar teknike për kryerjen e të gjitha punimeve/furnizim vendosjeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë për zbatimin e kontrates. Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale. Zbatimi i kontrates që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji. Në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), është hartuar dhe natyra dhe numri perkates i stafit teknik të nevojshëm për realizimin e kontrates brenda afatit 1 muaj.

**2.3.5.** Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të cilat të përfshijnë objektin e prokurimit, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- ISO 9001 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) – ose ekuivalent, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

- ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) – ose ekuivalent, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

*Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurrohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të Ligjit 162/2020 të Prokurimit Publik, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

#### **Konkretisht:**

**Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 9001 ose ekuivalent,** na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE I interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë. Përkatësisht kjo lloj ISO specifikon kërkesat për një 8renda cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme. Synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.

Me anë të kërkesës për paraqitjen e kësaj 8renda8utor ose të përditësuar, AK kërkon të vërtetojë se OE ka kapacitetin për të garantuar konformitetin me kërkesat cilësore të tij.

**Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 45001:2018 ose ekuivalent,** është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën janë të shumta dhe janë shtjelluar në kriteret e mësipërme, si dhe në specifikimet teknike të projektit të zbatimit. Për këtë arsye, AK duhet të sigurohet se OE zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Paisja me këtë lloj certifikimi dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

- 2.3.6.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit/distributorit të autorizuar për “Xham i temperuar”. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik duhet ta vërtetojë këtë duke paraqitur akt-marreveshje/autorizim/kontrate lidhur mes kompanisë prodhuese dhe distributorit të autorizuar.



Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve prodhuesit/ve te mallrave objekt prokurimi “**Xham i Temperuar**”, i cili te tregohen dhe te specifikohen qarte.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe propocion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë edhe natyrën, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së punimeve. Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga distributor i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara nga prodhuesi. Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit te cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet sherbim me “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 39 e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

**2.3.7.** Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë ne pronesi ose me qera pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës

<b>Nr</b>	<b>Lloji i pajisjes</b>	<b>Statusi</b>	<b>Sasia</b>
1	Sharrë profesionale për D/A plastik	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
2	Makineri për ngjitje D/A plastik	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
3	Makineri për pastrimin dhe rifiniturën e D/A plastik	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
4	Pantograf për hapjen e bravave në D/A plastik	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
5	Kamionçinë 3.5 – 5 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	1

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), çertifikatë pronësie e automjetit dhe leje transporti kurse për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, çertifikatë pronësie e automjetit dhe leje transporti (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin pajisje / automjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike.

**Shënim:** *Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë teknologjitë ekzistuese dhe nevojat për funksionalitet, zgjerim në cilësi e performancë të disa prej ambjenteve kryesore në zotërim nga Autoriteti Kontraktor, për blerjet e reja cilësore që zgjerojnë ato ekzistuese sipas objektit të procedurës së prokurimit, duke përllogaritur mënyrën e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve e garancive, karakteristikat e duhura, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ruajtur garancitë përkatëse, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Specifikimet teknike janë hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve ndërsa kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës pjese e njesise se prokurimit, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për produktet/shërbimet/garancitë objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.